

VENDIM
Nr. 492, datë 23.8.2023

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PERSONELIT TË STRUKTURAVE OPERACIONALE TË MBROJTJES CIVILE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISION HUMANITAR NË GREQI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 56, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e personelit të përbërë nga 38 (tridhjetë e tetë) personel të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, 3 (tre) personel i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe 7 (shtatë) punonjës të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të bashkive Korçë dhe Maliq, në mision humanitar, në Greqi.

2. Misioni i personelit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, është të mbështesë autoritetet që menaxhojnë dhe drejtojnë operacionet e përballimit të situatës së krijuar nga rënia e zjarreve në muajin gusht 2023 dhe do të zhvillojë operacione kërkim-shpëtimi në ambiente urbane (USAR) si dhe dhënie ndihme mjekësore të menjëhershme.

3. Venddislokimi i personelit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, është në *Alexandroupolis-Feres*, Greqi.

4. Kohëzgjatja e misionit humanitar të personelit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e nisjes së personelit.

5. Ministria e Mbrojtjes, për personelin ushtarak, dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për personelin civil dhe personelin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, përballojnë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit në mision, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) akomodim;

c) ushqim;

ç) ujë të pijshëm;

d) energji elektrike;

dh) lavanderi;

e) sigurim jete;

ë) siguracion shëndetësor jashtë zonës së misionit;

f) mbështetje shëndetësore;

g) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

gj) transport;

h) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disiplinore;

i) shpenzime të tjera për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

6. Transporti i personelit, që merr pjesë në mision në Greqi, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje discipline, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, për personelin

ushtarak dhe nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për personelin civil dhe personelin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, për personelin ushtarak, dhe nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, për personelin civil dhe personelin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, për vitin 2023.

8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, dhe bashkitë Korçë dhe Maliq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama